



UDHËZUES PËR ANGAZHIMIN E STUDENTËVE NË PROCESET E SIGURIMIT TË BRENDSHËM DHE TË JASHTËM TË CILËSISË NË ARSIMIN E LARTË NË KOSOVË

Autorë:

Dr. Anca Prisăcariu
Furtuna Mehmeti
Majlinda Mazelliu
Aleksandar Šušnjar



Ky projekt u financua përmes një granti të Ambasadës Amerikane në Prishtinë dhe u administrua nga KUSA. Mendimet, gjetjet dhe përfundimet apo rekomandimet e shprehura në të janë të autorit(ve) dhe nuk i pasqyrojnë medoemos qëndrimet e Departamentit të Shtetit.

Parathënie

Agjencia e Kosovës për Akreditim (AKA) ka arritur me sukses të sigurojë mbështetjen e Ambasadës së SHBA-së në Kosovë për financimin e projektit *Rritja e pjesëmarrjes së studentëve në proceset e brendshme dhe të jashtme të sigurimit të cilësisë në Kosovë*. Qëllimi i projektit është të inkurajojë pjesëmarrjen e studentëve në aktivitetet që kanë të bëjnë me sigurimin e cilësisë me qëllim që të kontribuon në përmirësimin e procesit të mësimdhënies dhe të nxënies. Sipas gjetjeve të projektit, rritja e përfshirjes së studentëve në sigurimin e cilësisë promovon përafrimin e sektorit të arsimit të lartë kosovar me shtetet anëtare të EHEA dhe në këtë mënyrë garanton një planifikim dhe zbatim të procesit mësimor me pjesëmarrje. Prandaj, rritja e ndërgjegjësimit dhe përfshirja e studentëve në proceset e brendshme të sigurimit të cilësisë, do të lehtësojë përfshirjen e studentëve në sigurimin e jashtëm të cilësisë, gjë që do të kontribuojë në përmbushjen e Planit Strategjik të AKA-së dhe rekomandimeve të ENQA.

Qëllimet e projektit janë përcaktuar si më poshtë:

1. Rritja e vetëdijes së studentëve për rëndësinë e përfshirjes së tyre në proceset e brendshme të sigurimit të cilësisë;
2. Inkurajimi dhe mbështetja e Institucioneve të Arsimit të Lartë për të përfshirë në mënyrë aktive studentët në proceset e sigurimit të cilësisë;
3. Mbështetja e zbatimit të Planit Strategjik të AKA-së në lidhje me përfshirjen e studentëve në sigurimin e jashtëm të cilësisë

Ky dokument bazohet në një krahasim të praktikave më të mira në Evropë, një analizë të politikave të EHEA-s, një analizë të legjislacionit në fuqi në vend, raporteve të akreditimit të AKA-së, si dhe në një anketë në nivel vendi të kryer me më shumë se 1000 studentë nga institucionet e arsimit të lartë publik dhe privat të Kosovës (IAL); së fundi, projekti bazohet në përvojën profesionale të ekipit të projektit, të përbërë nga ekspertë vendas dhe ndërkombëtarë.

I. Konteksti, fushëveprimi, konceptet dhe parimet

Konteksti

Që nga vitet 1990, roli i studentëve në sigurimin e cilësisë në arsimin e lartë është bërë i njohur në të gjithë Evropën si i domosdoshëm dhe i dëshirueshëm (Cockburn 2006). Përfshirja e studentëve bëhet në forma dhe nivele të ndryshme. Studentët përfshihen në proceset e sigurimit të cilësisë në institucionet e tyre të arsimit të lartë, si pjesë e sigurimit të cilësisë së institucioneve dhe programeve nga organe të jashtme; por edhe në rishikimin e sigurimit të cilësisë së vetë atyre organeve (Williams, 2006).

Me zbatimin e Zonës Evropiane të Arsimit të Lartë (EHEA), fillimisht i njohur si Procesi i Bolonjës, studentët njihen si palë kryesore e interesit që duhet të marrin pjesë në formimin e arsimit të tyre dhe përvojës së përgjithshme të të mësuarit. Komunikata e Pragës e nënshkruar nga të gjithë Ministrat e Arsimit të EHEA përcakton se studentët duhet të konsiderohen anëtarë të plotë të komunitetit të arsimit të lartë.

Komunikata e Berlinit, 2003, paraqet një miratim të pakushtëzuar të pjesëmarrjes së studentëve në qeverisjen e arsimit të lartë: *Ministrat vënë në dukje pjesëmarrjen konstruktive të organizatave studentore në Procesin e Bolonjës dhe nënvizojnë*

domosdoshmërinë e përfshirjes së studentëve në vazhdimësi dhe në faza të hershme në aktivitetet e mëtejshme. Studentët janë partnerë të plotë në qeverisjen e arsimit të lartë. Ministrat vënë në dukje se masat ligjore kombëtare për të siguruar pjesëmarrjen e studentëve janë në masë të madhe në fuqi në të gjithë Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë. Ata gjithashtu u bëjnë thirrje institucioneve dhe organizatave studentore që të identifikojnë mënyra për rritje të përfshirjes së studentëve në qeverisjen e arsimit të lartë.

Në vitin 2018, Komunikata e Parisit paraqet pjesëmarrjen e studentëve si një nga vlerat themelore të procesit. Më pas, komunikatat e tjera ministrore janë përkushtuar gjithnjë e më shumë për angazhimin e studentëve, duke përcaktuar kështu një valë të madhe të vendeve evropiane që po rrisin në vazhdimësi angazhimin e studentëve në qeverisjen e arsimit të lartë në përgjithësi, por edhe në sigurimin e cilësisë (QA) në veçanti.

Si anëtarë të komunitetit akademik, studentët e përfshirë në qeverisjen e arsimit të lartë kontribuojnë në mënyrë aktive dhe evidente në zhvillimin e politikave pasi janë ata që përfitojnë drejtpërdrejt nga kjo e mirë publike, duke kontribuar gjithashtu në rritjen e ndërgjegjësimit se si mund të zbatohen qasje të ndryshme për arritjen e qëllimeve të përbashkëta. Pjesëmarrja e studentëve nuk është vetëm thelbësore për mirëqenien e institucioneve demokratike, por edhe për shoqërinë tonë demokratike në tërësi (Bologna me Sytë e Studentëve 2020, 2021).

Fushëveprimi dhe konceptet

Ky dokument nuk përshkruan mënyrën se si duhet të ndodhë angazhimi i studentëve në sigurimin e brendshëm dhe të jashtëm të cilësisë në Arsimin e Lartë në Kosovë, por synon të ofrojë udhëzime se si studentët mund të kontribuojnë në ofrimin e cilësisë dhe në mjediset mësimore në arsimin e lartë. Udhëzimet duhet të përdoren gjithashtu si pikë referimi gjatë përcaktimit të legjislacionit të arsimit të lartë, dispozitave të akreditimit dhe rregulloreve të nivelit institucional, dhe është gjithashtu e dëshirueshme që palët vendore të interesit dhe institucionet e arsimit të lartë të kontribuojnë në miratimin dhe zbatimin e tyre të suksesshëm në praktikë.

Udhëzuesi duhet të shihet në një kontekst më të gjerë, i cili gjithashtu kupton dhe respekton diversitetin e institucioneve të arsimit të lartë - pavarësisht nga lloji i pronësisë, financimi dhe madhësia e tyre - të cilat mund të gjejnë mënyra tjera për angazhimin aktiv të studentëve; megjithatë, ky diversitet në profilin e institucioneve nuk duhet të përdoret si justifikim për mungesën e angazhimit të studentëve në qeverisje dhe sigurimin e cilësisë.

Fokusi i këtij dokumenti është siguri i cilësisë si një koncept i integruar dhe horizontal që funksionon si shtyllë kurrizore e çdo institucioni të arsimit të lartë, i cili mbulon të gjithë gamën e aktiviteteve dhe njësive institucionale; prandaj, këto udhëzime inkurajojnë angazhimin e studentëve në sigurimin e cilësisë së fushave akademike dhe jo akademike, duke përfshirë qeverisjen, planifikimin strategjik, politikë bërjen, administrimin, etj.

Duhet të bëhet një dallim konceptual ndërmjet përfshirjes dhe angazhimit të studentëve në sigurimin e cilësisë:

- Astin (1984) e ka përshkruar përfshirjen e studentëve si sasi të energjisë fizike dhe fiziologjike që studenti i kushton përvojës akademike, një përkufizim që i referohet

sjelljes dhe asaj që studentët bëjnë në të vërtetë a jo asaj që ata mendojnë ose ndjejnë ose kuptimi që ata japin përvojave të tyre;

- Trowler dhe Trowler (2011) e përkufizojnë angazhimin e studentëve si: investimi i kohës, mundit dhe resurseve tjera relevante, si nga studentët ashtu edhe nga institucionet e tyre, duke synuar në optimizimin e përvojës së studentëve dhe në përmirësimin e rezultateve të të nxëniet dhe zhvillimin e studentëve, si dhe përmirësimin e performancës dhe reputacionit të institucionit. Për më tepër, Kuh et al. (2007) e përshkruan angazhimin e studentëve si pjesëmarrje në praktika efektive arsimore si brenda ashtu dhe jashtë klasës, gjë që çon në një sërë rezultatesh të matshme. Ata gjithashtu deklarojnë se angazhimi i studentëve përfaqëson dy karakteristika kryesore: kohën dhe përpjekjen që studentët investojnë në studimet e tyre dhe në aktivitete të tjera arsimore; dhe mënyrën se si institucioni shpërndan burimet e veta dhe organizon kurrikulën, mundësitë e tjera të të nxëniet dhe shërbimet mbështetëse për të inkurajuar studentët të marrin pjesë në aktivitete që çojnë në përvoja/rezultate të dëshiruara, si qëndrueshmëria, kënaqësia, të mësuarit dhe diplomimi.

Megjithëse angazhimi dhe përfshirja e studentëve mund të duken e njëjta gjë, nuk është kështu. Edhe pse të ngjashme në kuptim, ato kanë një ndryshim cilësor mes tyre. Një student për shembull mund të përfshihet por jo të angazhohet në mënyrë aktive. E para i referohet një situatë ku për shembull një student që kandidon për një rol në një organizatë merr pjesë në një takim dhe përcjellë diskutimin. Kurse rasti tjetër i referohet një studentit që kandidon për një rol në një organizatë, merr pjesë në takime, shpreh shqetësimet e tij dhe merr pjesë aktive në diskutim (Kuh et al.2007).

Parimet

Ky dokument bazohet në një sërë parimesh të cilat mund të ndihmojnë institucionet në zhvillimin e një kulture të angazhimit për të integruar studentin si në qeverisje ashtu edhe në sigurimin e cilësisë. Parimet propozohen me bindjen se lidhshipi proaktiv i institucionit– duke përfshirë menaxhmentin e lartë dhe përfaqësuesit e studentëve – janë kushti *sine qua non* i një qasjeje aktive dhe mikpritëse ndaj angazhimit të studentëve.

Këto parime janë të bazuara pjesërisht në shtyllat e lëvizjes studentore (Unioni i Studentëve Evropianë, 2009) dhe Raporti i Grupit Punues për Angazhimin e Studentëve në Arsimin e Lartë në Irlandë (Autoriteti i Arsimit të Lartë, 2016).

Angazhimi i studentëve në qeverisjen e arsimit të lartë dhe sigurimin e cilësisë duhet të bazohet në parimet e mëposhtme.

1. Pavarësia

Studentët duhet të jenë në gjendje të shprehin pikëpamjet e tyre në mënyrë autonome, pa frikë nga pasojat apo përpjekjet për të ndikuar në opinionet e tyre. Kur zhvillohen zgjedhjet për përfaqësues të studentëve, këto duhet të organizohen nga vetë studentët, pa përfshirjen e institucionit apo palëve të tjera të interesit. Institucionet e arsimit të lartë, aty ku është e nevojshme, mund të mbështesin studentët me kapacitete logjistike, administrative dhe organizative, por kjo duhet të bëhet në një mënyrë që të garantojë autonomi të plotë të trupit studentor për të zgjedhur përfaqësuesit e tyre legjitimë.

Veprimtaria e përfaqësuesve të studentëve duhet të zhvillohet pa asnjë ndikim nga të diplomuarit, IAL-të, partitë politike, apo nga ndonjë palë tjetër e interesit.

2. Të qenit të hapur (openness)

Angazhimi i studentëve në zhvillimin e arsimit të lartë duhet të jetë një mundësi ku kanë mundësi qasjeje të gjithë studentët, pavarësisht nga performanca e tyre akademike, viti apo programi i studimit, mënyra e studimeve, statusi financiar, gjinia apo ndonjë kriter tjetër diskriminues. Po kështu, të gjithë studentët duhet të kenë të drejtën e votës dhe të zgjedhjes për postet e caktuara.

3. Demokracia

Institucionet do t'u përmbahen parimeve demokratike dhe do t'i inkurajojnë këto parime tek stafi, studentët dhe në shoqërinë e gjerë. Në rolet e zgjedhura, përfaqësuesit duhet të zgjidhen nga të gjithë studentët në nivelin përkatës (p.sh. studentët në Senat/Këshillin Akademik të zgjidhen nga të gjithë studentët në nivel institucional) dhe duhet të jenë në gjendje të shprehin qëndrimin e tyre dhe të votojnë për të gjitha çështjet.

4. Përfaqësimi

Në rolet e tyre të angazhimit, studentët do të kërkojnë të ndërtojnë dhe mirëmbajnë kanale efektive komunikimi me elektoratin e tyre, si në mbledhjen e opinionëve për të cilat ata më vonë duhet të kenë një qëndrim zyrtar, ashtu edhe në shpërndarjen e vendimeve në të cilat kanë qasje dhe të cilat ndikojnë tek studentët. Në rolet e tyre të zgjedhura, studentët kanë për detyrë të sigurojnë që opinionet që ata mbështesin të bazohen në konsultimet me elektoratin dhe të mos ndikohen nga asnjë palë e tretë (menaxhmenti i institucionit, alumni, partitë politike, etj.).

5. Transparenca

Institucionet do të jenë transparente në ciklin jetësor të proceseve të tyre vendimmarrëse, ndërsa studentët do të jenë transparentë në linjat e tyre të brendshme të qeverisjes dhe në marrëdhëniet ndërmjet përfaqësuesve të zgjedhur dhe studentëve. Institucionet do të jenë transparente në ciklin jetësor të proceseve të tyre vendimmarrëse, ndërsa studentët do të jenë transparentë në linjat e tyre të brendshme të qeverisjes dhe në marrëdhëniet ndërmjet roleve të zgjedhura dhe popullatës studentore.

Procesi i zgjedhjes për përfaqësuesit e studentëve duhet të bazohet në thirrje të hapura dhe transparente; përfaqësuesit e studentëve gjithashtu do të zhvillojnë dhe mirëmbajnë rregullore të qarta që sigurojnë formalitetin e procesit – duke siguruar të drejtat, përgjegjësitë dhe detyrimet e sakta për përfaqësuesit e studentëve, kohëzgjatjen e mandatit për çdo pozicion, përcaktimin e rrugëve të vendimmarrjes, etj.

Përfaqësuesit e studentëve do të sigurojnë gjithashtu se janë vendosur masat e duhura për të lehtësuar transferimin e njohurive nga viti në vit dhe ngritjen e kapaciteteve të përgjithshme të studentëve të përfshirë dhe përfaqësuesve të studentëve.

6. Integriteti

Institucionet duhet të promovojnë dhe mundësojnë integritetin e studentëve dhe palëve të tjera të interesit; përfaqësuesit e studentëve duhet të kuptojnë, pranojnë dhe zgjedhin të veprojnë në përputhje me parimet e përfshira në këtë seksion, duke demonstruar vazhdimisht ndershmëri, drejtësi dhe mirësjellje dhe duke iu përmbajtur një kodi të vlerave veçanërisht morale.

7. Studenti si partner

Perceptimi i studentëve si partnerë dhe jo si konsumatorë apo klientë është thelbësor. Studenti si partner është një anëtar aktiv i një institucioni me të cilin ai/ajo ndanë një ndjenjë të fortë besnikërie dhe përkushtimi. Kjo nënkupton jo vetëm kërkimin e kontributit të studentëve në aspektet vendimmarrëse, strategjike, konsultative dhe ekzekutive të përfaqësimit, por gjithashtu supozimin e një kuptimi të vërtetë se një perspektivë studentore mund të sjellë vlerë të shtuar për rritjen e cilësisë në të gjitha nivelet.

8. Gjithëpërfshirja dhe diversiteti

Institucionet do të kërkojnë në mënyrë aktive të marrin njohuri dhe kontribute nga të gjithë sektorët e komunitetit akademik në proceset e tyre të qeverisjes dhe vendimmarrjes. Kjo do të shkojë përtej kërkesave formale legjislative, për të ofruar një mori mundësish për angazhim formal dhe joformal. Ndërsa institucionet lokale dhe autoritetet kombëtare bëhen më të diverse në kuptimin shoqëror dhe kulturor, studentët do të punojnë për të siguruar që natyra diverse e trupit studentor të ruhet në aktivitetet e tyre përfaqësuese, duke u kujdesur që përbërja e organeve përfaqësuese të pasqyrojë së paku nivelin e diversitetit të popullatës së përgjithshme.

9. Studentët si bashkë krijues

Nga studentët pritet që të marrin përgjegjësinë për të mësuarit e tyre dhe për rolin e tyre si partner në qeverisjen dhe sigurimin e cilësisë së arsimit të lartë. Kjo nënkupton që studentët jo vetëm të jenë burim i vlefshëm i komenteve kthyesë mbi cilësinë e përvojave të tyre mësimore dhe burim i perspektivës unike në procesin arsimor, por edhe partnerë të besueshëm me një rol operacional në proceset e projektimit, inovacionit dhe zbatimit. Institucionet lokale dhe autoritetet kombëtare do të përqafojnë përfshirjen aktive të studentëve.

10. Kolegjialiteti dhe barazia e vlerësimit

Institucionet lokale, autoritetet kombëtare dhe përfaqësuesit e studentëve do të promovojnë kolegjialitetin ndërmjet stafit dhe studentëve në të gjithë sektorin akademik. Në qendër të kolegjialitetit është zhvillimi i një marrëdhënieje të hapur dhe të besueshme ndërmjet secilit anëtarë të stafit dhe studentëve brenda arsimit të lartë.

11. Profesionalizmi dhe mbështetja

Studentët dhe përfaqësuesit e tyre do të kontribuojnë plotësisht dhe do të veprojnë në mënyrë profesionale kur përfshihen në strukturat dhe proceset e IAL-së. Ky profesionalizëm është përgjegjësi e përbashkët e institucionit dhe përfaqësuesve të studentëve. Institucioni do të pranojë që anëtarët e stafit dhe studentëve në komitete mund të kenë përvoja të ndryshme jetësore dhe fusha të ekspertizës, por të gjithë vlerësohen njëllë në zhvillimin e vazhdueshëm të institucionit. Do të jetë përgjegjësi e institucionit të sigurojë mbështetjen e nevojshme për përfaqësuesit e studentëve që ata të kenë mundësi të përmbushin rolin e tyre.

12. Cikli i komenteve kthyesë

Institucionet do të mirëpresin dhe inkurajojnë komentet kthyesë të hapura dhe të menjëhershme nga studentët. Masat e duhura do të vendosen në të gjithë institucionin për të siguruar që studentët e kanë të lehtë të japin komente kthyesë në një mënyrë të sigurt dhe të vlefshme. Praktikrat e reagimit do të jenë transparente dhe cikli i komenteve kthyesë do të mbyllet në kohën e duhur; Masat e ndërmarra nga institucioni si përgjigje në komentet kthyesë të studentëve do të shpërndahen në mënyrë transparente.

13. Vetëkritika dhe përmirësim

Përfaqësuesit e studentëve dhe institucionet do të vazhdojnë të jenë vetë-analitik dhe autokritikë ndaj praktikave të tyre të angazhimit studentor. Ata do të përdorin teknika të bazuara në fakte për të vlerësuar, kritikuar dhe, bazuar në këtë, për të avancuar vazhdimisht efektivitetin e strategjive të tyre për ndërtimin e një kulture angazhimi.

14. Konsistenca

Institucionet dhe përfaqësuesit e studentëve do të sigurojnë që vlerat dhe praktikat në lidhje me angazhimin e studentëve zbatohen në mënyrë të vazhdueshme në të gjitha institucionet dhe duhet të vendosin procedura për të lejuar departamentet të ndajnë praktikat e ira mes vete, si dhe të stimulojnë shkëmbimin e përvojave ndërmjet përfaqësuesve të studentëve.

II. Udhëzues për pjesëmarrjen e studentëve në procese të sigurimit të brendshëm të cilësisë

1. Pjesëmarrja e studentëve në strukturat udhëheqëse të IAL-ve

Në përputhje me Manualin e Akreditimit të AKA-së (AKA, 2018), përfaqësuesit e studentëve janë anëtarë të barabartë të të gjitha organeve planifikuese, vendimmarrëse, ekzekutive dhe konsultative në nivel institucional, fakultet dhe departament. Përfaqësimi i studentëve inkurajohet efektivisht në sektorë formal dhe joformal të qeverisjes dhe organizohet në përputhje me parimet e renditura në seksionin 1 të këtij dokumenti.

Në rastet kur institucionet përballen me barriera ligjore për integrimin e studentëve si anëtarë të plotë (me fuqi votuese) të organeve strategjike, vendimmarrëse, ekzekutive dhe konsultative si në nivel institucional ashtu edhe në atë të fakultetit, do të bëhet zgjidhje e përkohshme për statusin e tyre duke i klasifikuar ata si vëzhgues. Në raste të tilla kalimtare, përfaqësimi i zërit të studentëve mund të lehtësohet duke mbështetur zhvillimin konstruktiv të një kulture ku studentët mund të shprehin mendimin e tyre në takime formale, pavarësisht nga statusi i tyre zyrtar i anëtarësimit.

Në institucionet që ofrojnë programe edhe në kampuset e degëve, duhet të sigurohet përfshirja dhe angazhimi i studentëve të regjistruar edhe në degë.

Duke pasur parasysh se nocioni i pjesëmarrjes dhe angazhimit të studentëve në arsimin e lartë të Kosovës është në fillimet e tij, ekziston detyrimi etik i bartjes së njohurive të fituara nga studentët paraprak tek studentët e rinj përfaqësues studentor, pavarësisht se kush do të jetë përfaqësuesi i ardhshëm legjitim i studentëve. Kjo do të kontribuojë në ngritjen e kapaciteteve dhe vazhdimësinë e memorjes institucionale në çështjet e përfaqësimit të studentëve. Për më tepër, mekanizmat e llogaridhënies, transparencës dhe rrjedhës së informacionit për përfaqësuesit e tjerë të studentëve apo thjeshtë student, duhet t'i kushtohet vëmendje e veçantë.

1. Përfshirja e studentëve në procese të sigurimit të cilësisë në nivele dhe struktura menaxheriale

Ekziston përfaqësim i studentëve në të gjitha komitetet formale dhe joformale të sigurimit të cilësisë në nivel institucional, fakultet dhe departament; kjo është e rregulluar në përputhje me parimet e renditura në seksionin 1 të këtij dokumenti. Është e një rëndësie kyçe që studentët dhe institucionet e arsimit të lartë të kuptojnë qartë objektivat dhe nevojat e njëri-tjetrit në lidhje me sigurimin e cilësisë për të mundësuar një angazhim efektiv të të dyja palëve në proces.

Më tej, studentët duhet të angazhohen si vlerësues të barabartë në vetëvlerësimet/auditimet e brendshme periodike të koordinuara nga komitetet e sigurimit të cilësisë në nivel institucioni ose fakulteti, në lidhje me përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë dhe jo domosdoshmërisht në lidhje me një proces të jashtëm të sigurimit të cilësisë.

2. Strategji për rritjen e përfshirjes së studentëve

Në Zonën Evropiane të Arsimit të Lartë, angazhimi i studentëve është një nga shtyllat kryesore për performancën pozitive dhe efektive të institucioneve të arsimit të lartë, si në qeverisje ashtu edhe në strukturat e sigurimit të cilësisë. Për shkak të dallimeve ndërmjet institucioneve në Kosovë, shkalla dhe efikasiteti i angazhimit të studentëve mund të ndryshojnë. IAL-të duhet të sigurohen që të kenë një strategji dhe plan veprimi të qartë për të siguruar përfshirjen e studentëve në qeverisje dhe sigurim të cilësisë, duke ofruar aktivitete të mjaftueshme mbështetëse për studentët.

Në këtë drejtim, burimet përkatëse duhet të ndahen për të mbështetur angazhimin e studentëve.

3. Dizajnimi, aprovimi, monitorimi dhe rishikimi i programeve të studimit

Në përputhje me Standardet dhe Udhëzuesit Evropian për Sigurimin e Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG, 2015), programet hartohen dhe rishikohen rregullisht me përfshirjen e studentëve në proces. Kjo nënkupton që studentët duhet të jenë anëtarë të barabartë të organeve përgjegjëse për mbikëqyrjen, vlerësimin dhe rishikimin e programeve ekzistuese të studimit.

Në rastin e krijimit të një programi të ri, studentë nga programe të ngjashme të institucionit mund të ftohen të marrin pjesë, ose studentë nga i njëjti program të ofruar në institucione të tjera të arsimit të lartë.

ESG nënvizon më tej angazhimin e palëve të tjera të interesuara në proceset që lidhen me hartimin, monitorimin dhe rishikimin e programit (si stafi akademik dhe administrativ, alumni, përfaqësues të tregut të punës); ndërkohë që një angazhim i tillë nuk është objekt i këtij dokumenti, pjesëmarrja aktive e kategorive të tjera nuk duhet të anashkalohet nga IAL-të.

4. Zhvillimi dhe hartimi i lëndëve

Studentët duhet të jenë të përfshirë drejtpërdrejtë në zhvillimin e programit dhe lëndëve përmes pjesëmarrjes në ekipe të ndryshme ose grupe pune të krijuara për këto qëllime. Kjo u jep studentëve një rol aktiv në formësimin e rrugëtimit të tyre të të mësuarit, përfshirë fusha të tilla si vlerësimi, objektivat e të mësuarit ose metodat e mësimdhënies. Kjo forcon idenë se studentët janë pjesë e komunitetit akademik dhe bashkëndërtues, gjë që sjell një nivel shumë të lartë besimi për rrugëtimin e tyre mësimor, por gjithashtu u

mundëson atyre të bëhen mësim-nxënës autonom gjatë gjithë jetës, gjë që është një domosdoshmëri në arsimin bashkëkohor. Në veçanti, studentët shihen si hisedarë të studimeve të tyre dhe e dinë më së miri se çfarë do t'i përmirësonite dhe plotësonite edhe më tutje studimet e tyre. Institucionet madje duhet të konsiderojnë që t'u ofrojnë studentëve një buxhet të vogël për të zhvilluar kurset dhe projektet e tyre, për të ftuar folës ose për të ligjëruar një temë jashtë kurrikulare nëse ata janë shumë të mirë në të.

5. Marrja parasysh e zërit të studentëve në zhvillimin dhe implementimin e instrumenteve të sigurimit të cilësisë

Institucionet duhet në vazhdimësi të mbledhin komente të studentëve në lidhje me të gjithë gamën e aktiviteteve institucionale. Kjo nuk duhet të kufizohet vetëm në cilësinë e përvijës së tyre mësimore, por edhe në cilësinë e infrastrukturës dhe objekteve, administratës, shërbimeve mbështetëse, aktiviteteve jashtëkurrikulare, praktikave etj. Është me rëndësi kyçe që institucionet të veprojnë në kohë në lidhje me komentet e studentëve duke adresuar shqetësimet kryesore dhe duke u siguruar që ndryshimet janë bërë të dukshme për studentët.

Komentet e studentëve duhet të mblidhen në mënyrë anonime, por gjithashtu të analizohen dhe krahasohen me komentet e mëparshme për të njëjtën lëndë, të cilat më pas do të zbulojnë nëse të njëjtat çështje të ngjashme janë ende shqetësuese, pra duhet të synohet se shqetësimet e njëjta nuk janë përsëritur.

Mënyra kuantitative e mbledhjes së feedback duhet të plotësohet edhe me mënyrën kualitative, siç janë fokus grupet, grupet konsultative student-staf, të cilat lejojnë diskutimin e thellë të shqetësimeve të studentëve dhe gjithashtu zvogëlojnë kohën e përgjigjes nga institucioni.

Në lidhje me zhvillimin mjeteve dhe mënyrave të tjera të pjesëmarrjes, studentët mund të ftohen të kontribuojnë në:

- hartimin dhe rishikimin e të gjitha anketave të kryera nga institucioni; studentët mund të kenë një kontribut të vlefshëm në sugjerimin e përmbajtjes së sondazhit, një gjuhë lehtësisht të kuptueshme nga studentët, formatin e pyetjeve, gjatësinë e anketave, etj.;
- mënyra e shpërndarjes së veprimeve institucionale ndaj feedback të studentëve; fitimi i besimit të studentëve si rezultat i ofrimit të feedback-ut për përmirësimin e cilësisë institucionale është me rëndësi të madhe, prandaj institucioni mund të konsultohet me përfaqësuesit e studentëve për mënyrën më të mirë për të arritur tek studentët me shpërndarje transparente të veprimeve që institucioni ka ndërmarrë në përgjigje të komenteve të tyre.

III. Udhëzues për përfshirje të studentëve në procese të jashtme të sigurimit të cilësisë

1. Partnerët në nivelin vendor

Institucionet përkatëse kombëtare si Zyra e Kryeministrit, Ministria e Arsimit, Shkencës dhe Teknologjisë, Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, Agjencia e Kosovës për Akreditim etj. duhet të kërkojnë angazhimin e studentëve në të gjitha proceset e hartimit të legjislacionit në lidhje me arsimin e lartë. Për më tepër, këto palë të interesit duhet të mbështesin ndryshimin e çdo pjese të legjislacionit që do të lehtësonite integrimin e

anëtarëve studentë në kuadër të nivelit menaxherial të institucioneve të arsimit të lartë dhe AKA-së, si Ligji për Arsimin e Lartë, Statuti i IAL-ve, Udhëzimet Administrative përkatëse etj.

Është me rëndësi kyçe që Unioni Studentor i Republikës së Kosovës (USRK) të ristrukturohet dhe të rishqyrtojë prioritetet e tij në atë mënyrë që t'i mundësojë organizatës të përmbushë qëllimin për të cilin është krijuar. USRK ftohet të reflektojë në mënyrë kuptimplote mbi shtyllat e lëvizjes studentore siç parashihet në Manualin për Zhvillimin e Unionit Studentor (Unioni i Studentëve Evropian, 2009). Ka shumë komponentë që lidhen me ngritjen e kapaciteteve të studentëve në fushën e arsimit të lartë në përgjithësi dhe sigurimin e cilësisë në veçanti, të cilët duhet të mbështeten dhe të koordinohen nga një përfaqësues autonom i studentëve, në vend të AKA ose IAL. Kjo përfshin por nuk kufizohet në emërimin e studentëve për anëtarësim në bordin e AKA-së, nxitjen e angazhimit të studentëve në sigurimin e brendshëm të cilësisë, lehtësimin e një komunikimi më të përshtatshëm dhe dialog me institucionet e nivelit kombëtar si MASHT-i për qëllime të politikëbërjes etj.

2. Niveli i Agjencisë së Kosovës për Akreditim

a. Angazhimi në strukturat e agjencisë

Përfaqësuesit e studentëve duhet të angazhohen si anëtarë të plotë të të gjitha trupave qeverisëse të AKA-së, Këshillit Shtetëror të Cilësisë, Departamenteve, Komisioneve (përfshirë komisionin e ankesave, komisionin e etikës, çdo komision tjetër të aplikueshëm) dhe divizionet tjera relevante.

Në rastet kur AKA përballet me sfida legjislative për të integruar studentët si anëtarë të plotë (me fuqi të votës), zgjidhje do të bëhen për të mundësuar statusin e anëtarëve të studentëve si anëtar vëzhgues. Sipas këtyre aranzhimeve të përkohshme, zëri i studentëve mund të lehtësohet duke mbështetur zhvillimin konstruktiv të një kulture ku studentët mund të shprehin zërin e tyre në takime formale, pavarësisht statusin formal të anëtarësisë së tyre.

Anëtarësia e studentëve duhet të zgjerohet në të gjitha ekipet e projekteve të brendshme apo zhvillimore të themeluara nga AKA, përfshirë ekipet e vet vlerësimit, planifikimit strategjik, dhe ekipet e projekteve të cilat dorëzohen për financim të jashtëm.

b. Angazhimi në hartimin e proceseve të sigurimit të jashtëm të cilësisë

Zëri i studentëve duhet të reflektohet në çdo proces politik bërës të koordinuar nga AKA, përfshirë hartimi i manualeve, procedurave, metodologjive, si dhe propozimeve të cilat iniciohen nga agjencia për hartimin dhe rishikimin e legjislacionit relevant të sigurimit të cilësisë sikurse, ndër të tjera, të ligjeve dhe udhëzimeve administrative të akreditimit.

Studentët mund gjithashtu të përfshihen në trajnime dhe punëtori për vlerësuesit e jashtëm të sigurimit të cilësisë si bashkë hartues të përmbajtjeve dhe si folës; kjo do të ndihmojë të sigurohet se perspektiva e studentëve ngulitet në përmbajtjen e trajnimeve e cila i ofrohet vlerësuesve të jashtëm.

c. Angazhimi i studentëve në ekipet e ekspertëve të akreditimit

Në përputhje me Standardet dhe Udhëzuesit Evropian të Sigurimit të Cilësisë në Arsimin e Lartë (ESG, 2015), studentët duhet të angazhohen në të gjitha ekipet e vlerësuesve të jashtëm, pa përjashtim, për (ri)akreditimin e të gjitha institucioneve dhe programeve të studimit. Në përputhje me praktikat më të mira ndërkombëtare, brenda ekipeve të ekspertëve, studentët duhet të trajtohen si anëtarë të barabartë, përfshirë të drejtat dhe përgjegjësitë, dhe të drejtën e barabartë të pagesës sikurse pjesa tjetër e ekipit të ekspertëve.

Gjithashtu, në përputhje me ESG-të, pjesëmarrja e studentëve në ekipet e vlerësimit duhet të përzgjidhet me kujdes; studentët duhet të kenë aftësitë e përshtatshme dhe të jenë kompetent për të kryer detyrat e tyre, dhe ata duhet të mbështeten me trajnime përkatëse. Në këtë drejtim, agjencia e akreditimit mund të themelojë një grup të ekspertëve student, të cilit i përzgjedh në mënyrë të pavarur dhe siguron trajnime të përshtatshme për ta; megjithatë, në momentin kur grupi i ekspertëve të ketë kapacitetin e duhur, duhet të lejohet të operohet i vetëm nga studentët, me mbështetjen e AKA-së për ripërtëritjen periodike të anëtarësisë dhe trajnime të reja.

Përderisa parimi i angazhimit të studentëve reflektohet njëlloj nëse studentët e angazhuar në procedurat e akreditimit janë vendor apo ndërkombëtarë, AKA mund të konsiderojë rritjen e përpjekjeve të saj për ndërtimin e kapaciteteve për përfaqësimin e studentëve kosovar përmes angazhimit të tyre në operacione të ndryshme të sigurimit të cilësisë.

3. Strategjitë për përfshirjen e studentëve

Akterët vendor, sikurse MASHTI, AKA dhe Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve, duhet të zhvillojnë strategji dhe plane të veprimit për të siguruar të kuptuarit e studentëve dhe angazhimin e tyre në çështjet që lidhen me politik bërjen dhe qeverisjen në arsimin e lartë në nivelin vendor, së bashku me ofrimin e aktiviteteve mbështetëse për studentët. Burimet për ndërtimin e kapaciteteve në këtë drejtim duhet të planifikohen.

4. Zhvillimi i Anketës Vendore të Studentëve (NSS)

Një anketë vendore e studentëve duhet të zhvillohet me qëllimin që të ndihmohen institucionet e arsimit të lartë të përmirësojnë angazhimin e tyre me trupat studentore, t'i shtojnë vizibilitet vendor kënaqshmërisë së studentëve në secilin institucion, të shtojnë një pikë objektive dhe të jashtme të të dhënave të cilat çojnë në përmirësim, të sigurojnë një mekanizëm të plotë konfidencial të mbledhjes së informatave kthyesë (të mbledhura nga jashtë) të cilit studentët i besojnë pa frikën e hakmarrjes si dhe të shërbejnë si informacione për politik bërjen.

Një anketë e tillë do të kishte studentët në qendrën e tij, dhe do të kërkonte matjen e cilësisë së përvojës së studentëve në IAL-të dhe se si studentët angazhohen në ambientet e tyre të mësimin. Si pasojë, kjo do të informonte zgjidhjet e studentëve të ardhshëm, do të siguronte të dhëna të cilat mbështesin institucionet për përmirësimin e përvojës së studentëve dhe do të mbështeste llogaridhënien publike të institucioneve të arsimit të lartë.

5. Angazhimi i vazhdueshëm në proceset e sigurimit të jashtëm të cilësisë

Ekipet e ekspertëve të angazhuar në vizitat e (ri) akreditimit në nivelin institucional dhe atë të programeve të studimit, duhet të kenë qasje në një reflektim të pavarur dhe të pa filtruar të zërit të studentëve tek institucioni nën vlerësim, i cili mund të mbështetet nga njëri nga mekanizmat vijues:

- Të sigurojë AKA qasje në bazat e të dhënave të studentëve të regjistruar në të gjitha institucionet e arsimit të lartë, nga të cilat, agjencia mund të nxjerrë p.sh. 20 emra të studentëve të cilët ekipet e ekspertëve do të mund t'i takonin gjatë vizitës së (ri) akreditimit, prej të cilëve institucioni mund të zgjedhë 10;
- AKA të kërkojë nga institucioni/programi i studimit nën procesin e akreditimit, publikimin apo informimit e të gjithë studentëve për kohën, datën dhe vendndodhjen e takimit me ekipin e ekspertëve, ku çdokush mund të merr pjesë lirisht;
- Në rastet kur ekzistojnë unionet e studentëve apo ndonjë formë tjetër e përfaqësimit të pavarur të studentëve, këta të fundit mund të ngarkohen me përzgjedhjen e grupeve të studentëve të cilët marrin pjesë në takimet me ekipet e ekspertëve;
- Agjencia e akreditimit mund të kryejë anketat e veta të hapura me studentët të cilët janë të regjistruar në institucionin/programin e studimit, para çdo procesi të (r) akreditimit; rezultatet e të cilave gjithashtu do t'i dërgohen ekipit të ekspertëve si material përgatitor.

Referencat

D. Cockburn, Report of the higher education mapping exercise of student involvement in quality assurance and enhancement processes, (sparqs, 2005)

Williams P. (2006). In: Alaniska H. et al. (eds.) Student involvement in the processes of quality assurance agencies. Helsinki: European Association for Quality Assurance in Higher Education

The Prague Communiqué (2001). Towards the European Higher Education Area. Communiqué of the Conference of European Ministers Responsible for Higher Education. Prague, Czech Republic

The Berlin Communiqué (2003). Realising the European Higher Education Area. Communiqué of the Conference of European Ministers Responsible for Higher Education. Berlin, Germany

The Paris Communiqué (2018). Communiqué of the Conference of European Ministers Responsible for Higher Education. Paris, France

European Students Union (2021). Bologna with Student Eyes 2020. Brussels, Belgium

Astin, A. W. (1984). Student involvement: A developmental theory for higher education. Journal of College Student Personnel, 25(4), 297–308

V. Trowler and P. Trowler, (2011) Student engagement toolkit for leaders. Leadership foundation for higher education and Higher Education Research and Evaluation

Kuh, G.D., Kinzie, J., Buckley, J.A., Bridges, B.K. and Hayek, J.C. (2007) Piecing Together the Student Success Puzzle: Research, Propositions, and Recommendations. ASHE Higher Education Report, Vol 32, No 5. San Francisco: Jossey-Bass

The European Students' Union (ESU) (2009), The Student Union Development Handbook, Brussels, Belgium

Higher Education Authority (2016), Report of the Working Group on Student Engagement in Irish Higher Education, Dublin, Ireland

Kosovo Accreditation Agency, 2018, Accreditation Manual

Standards and Guidelines for Quality Assurance in the European Higher Education Area (ESG). (2015). Brussels, Belgium